



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:013355
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05636419

C.nr.82/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K...S.... nga Mitrovica, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson Av.Festim Shala nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Gjejljan Pasoma, avokate me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensimi i shujtës ushqimore, jashtë seancës gjyqësore, me datën 30.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
(Në bazë të pohimit)

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K...S.... nga Mitrovica, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses, në emër të kompensimit për ushqim (shujtë ditore) gjatë punës, t'i kompensoj shumën në lartësi prej 156€, për 78 ditë pune për periudhën nga data 12.03.2020 deri me 30.12.2020, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë (datë 16.01.2023) deri në pagesën e tërsishme, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- II. OBLIGOHET** e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00€, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Arsyetim

Paditësja, me datën 16.01.2023, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me anë të së cilës kanë kërkuar që të obligohet e paditura t'i paguaj në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës, për paditësen shumën në lartësi prej 156€, për 78 ditë pune për periudhën nga data 12.03.2020 deri me 30.12.2020. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 02.02.2024, e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e shujtës ushqimore.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 148 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadiës nga ana e të paditurit, lidhur më kompensimin e ushqimit në punë (shujtave ushqimore), konstatoi se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët mund të disponojnë lirshëm, në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të LPK, me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimin në bazë të pohimit)”* vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 dhe nenit 453 paragrafi 1 dhe 2 të LPK, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare t’ia kompensojë shpenzimet gjyqësore. Lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë shumë prej 104 euro dhe taksës gjyqësore shumë prej 20 euro, përkatësisht shumë prej 124 euro.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.82/2024, datë 30.04.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit se të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.